



**VENDIM**

*Nr. 11 Date 02.03.2009*

**PËR  
LIÇENSIMIN E SHOQËRISË  
“TERMOCENTRALI VLORË” SH.A PËR KRYERJEN E  
AKTIVITETIT TË PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 9, dhe 13 pika 1, gërma a, dhe 15, të Ligjit Nr. 9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar, neneve 5, gërma a, 13 dhe 14 pika 1, të “Rregullores për procedurat e liçensimit, modifikimit, transferimit të plotë /të pjesshëm dhe rinovimit të licensave”, të miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve Nr.108 datë 09.09.2008, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 02.02.2009, mbasi shqyrtoi aplikimin e shoqërisë Termocentrali Vlorë sh.a dhe relacionin e Drejtorise se Licensimit dhe Monitorimit të Tregut, mbi liçensimin e shoqërisë Termocentrali Vlorë sh.a në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike,

**Dhe konstatoi se:**

- Aplikimi plotëson përgjithësisht kërkesat e ERE lidhur me liçensimet në sektorin e energjisë elektrike.
- Mungesa e Dokumentacionit që ka të bëjë me:

Kryerjen e pagesës së regjistrimit të aplikimit për liçensë pranë ERE-s (*neni 9, pika 3, gërma d*)

Eshtë i lidhur me arsye objektive që dalin jashtë mundësive të kompanisë për të paraqitur atë brenda afatit të shqyrtimit të aplikimit në ERE si dhe me çeljen e fondit përkatës nga KESh sh.a.

- Liçensimi i kësaj shoqërie lidhet ngushtë me kryerjen e një investimi publik përmes ngritjes së termocentralit në zonën e Vlorës, dhe përbën një nga investimet më të mëdha për sektorin elektroenergjitik i kryer me kontributin e perbashket të Bankes Boterore, BERZH, BEI, marreveshje keto të ratifikuara nga Parlamenti shqiptar,



REPUBLIKA E SHQIPERISE  
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISE  
Bordi i Komisionereve



Për gjithë sa më sipër Bordi i Komisionerëve

**Vendosi:**

1. Të liçensojë shoqërinë Termocentrali Vlorë sh.a për kryerjen e aktivitetit të prodhimit të energjisë elektrike për një afat 30 vjet.
2. Shoqëria Termocentrali Vlorë sh.a të kryejë pagesën e rregjistrimit të aplikimit për liçensë menjëherë me çeljen e fondit për këtë pagesë nga KESH sh.a.
3. Ngarkohet Drejtoria e Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.



Votimi i Bordit të Komisionerëve të ERE-s për,

VENDIMIN  
Nr.11, Date 02.03.2009

PËR  
LIÇENSIMIN E SHOQËRISË  
“TERMOCENTRALI VLORË” SH.A PËR KRYERJEN E  
AKTIVITETIT TË PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Anëtarët e Bordit

	Pro	Kundër
Bujar Nepravishta	_____	_____
Entela Shehaj	_____	_____
Ardian Haçi	_____	_____
Abaz Aliko	_____	_____
Shkëlqim Bozgo	_____	_____

